


Motrat e Vogla të Jezusit në mesin e popullit shqiptar

Vëllazëria e Motrave të Vogla të Jezusit ka qenë e pranishme për gati 20 vjet në mesin e arbëreshëve të Italisë ...




Vëllazëria e Motrave të Vogla
në Ejanina, Itali, 1972



Veshje karakteristike të arbëreshëve

...dhe 20 vjet në mesin e popullit shqiptar në Kosovë.



Vëllazëria e Motrave të Vogla në Prishtinë



Motrat e vogla të Jezusit u vendosën në Tiranë në vitin 1998.



Kur erdhëm në Shqipëri kërkuam me zemër të hapur ta japim përgjigjen tonë ndaj thirrjeve urgjente dhe atyre të jetës së përditshme. Menjëherë jemi përfshirë thellësisht në lëvizjen e shumë shqiptarëve që pas vitit 1991 janë larguar në drejtime të ndryshme jashtë vendit të tyre. Më vonë është paraqitur



emergjenca e refugjatëve shqiptarë të Kosovës, ku bashkësia jonë qëndroi 20 vjet.

Kemi bashkëpunuar me shoqata të ndryshme për të ndihmuar materialisht në Tiranë dhe në Kukës, por e rëndësishme ka qenë mbështetja jonë morale.

Dhe pas kthimit të shumicës së refugjatëve, shoqërimi i personave të ndryshëm në Kosovë, të cilët qëndruan për një kohë të gjatë të shtruar në spitalin e Tiranës, sidomos në repartin onkologjik, për sëmundje që vinin si rrjedhojë e traumave të luftës.

Prania e Motrës së Vogël Josée Jeannine afër grave të burgosura, për më shumë se 5 vjet tashmë, është sidomos një prani dëgjimi e miqësie. Ajo viziton fëmijët e këtyre grave që gjenden në Shtëpitë e Mikpritjes në Shkodër dhe në Tiranë, dhe shoqëron gratë që dalin nga burgu. Për disa prej tyre, Vëllazëria jonë bëhet një pikë referimi.



Besojmë se edhe puna e Motrës së Vogël Odette Louise për përkthimet në gjuhën shqipe ka një ndikim të fortë shoqëror si për tekstet fetare, ashtu edhe për kërkimet në tekstet e kulturës shqiptare. Përmendim këtu Pjetër Bogdanin, i cili vë në dukje identitetin e popullit shqiptar, si edhe Fjalorin e Teologjisë Biblike në gjuhën shqipe, që ka dalë së fundmi nga shtypi, i cili do të jetë një ndihmë shumë e madhe jo vetëm për klerin e ri shqiptar, por edhe për të gjithë ata që kërkojnë të thellohen më shumë në fe.

Falë këtyre përkthimeve, Motra e Vogël Maria Lucia përgatit artikujt dhe prezantimet në Powerpoint për të bërë të njohur Vëllain Sharl dhe karizmën e Vëllazërisë që sot na duket shumë aktuale. Shqipëria gjithmonë e më shumë është një vend i privilegjuar për të jetuar marrëdhëniet ekumenike dhe, sidomos në këtë kohë në të cilën populli shqiptar është i tunduar nga materializmi, përshpirtëria e Vëlla Sharlit mund të ndezë një dritëz me mesazhin e vet të jetës suditëse, të dhurimit falas dhe dashurisë universale.


Emergjenca e fëmijëve të braktisur na ka dhënë mundësinë për të bashkëpunuar me Shoqatën “Fëmijët e botës, të drejtat e njeriut”, që ka vepruar me pakicat etnike të romëve. Në fillim, Motra e Vogël Hélène Jeanne ka punuar në gardërobë. Tani që nuk ka më punë, vazhdon kontaktin me familjet në një lagje shumë të varfër. Shoqata, që tani quhet “Fëmijët e botës dhe të Shqipërisë”, vazhdon të bëjë vepra nxitjeje dhe përfshirjeje, me qëllim që romët të njihen më mirë dhe të respektohen duke filluar nga shkolla.



Në takimet e përditshme, gjithashtu, kemi raste nga më të ndryshmet:

- ndihma që u japim njerëzve për të kërkuar respektimin e të drejtave të tyre dhe gëzimi për suksesin që vjen pas një ngulmimi të mundimshëm është një dhuratë e çmueshme e ndërsjellë;
- ndihma për të qenë krijues në gjetjen e zgjidhjeve të reja për probleme të punës, mjekimit, për ndjekjen e studimeve, dhe shpesh hapen rrugë të reja hap pas hapi;
- vënia në kontakt mes atyre që ndodhen në vështirësi me shoqata apo njerëz që mund t'i ndihmojnë: për shembull një profesionist që ofron kohën e tij të lirë javore me një djalë/vajzë që ka vështirësi të studiojës.
- pastaj me fqinjët ka mijëra raste për të qenë të vëmendshëm për ndonjë shërbim të vogël, kryesisht ndaj njerëzve të moshuar: shoqërimi te mjeku, marrja e pensionit apo vizita në varreza tek të dashurit e tyre në një qytet tjetër.

Vëllazëria e Motrave të Vogla është e hapur për të gjithë.



Vëllazëria e Motrave të Vogla në Tiranë

Përpiqemi që në gjithçka të kemi një kujdes të madh bashkësior, me qëllim që secili të mund të nxjerrë nga vetja më të mirën e mundshme, duke shmangur çdo paternalizëm, duke u përpjekur sidomos që të vazhdojmë të dëshmojmë të qenit falas.

Ashtu si Jezusi gjatë jetës së tij njerëzore, edhe ne dëshirojmë që të bëhemi plotësisht të të gjithëve duke mësuar gjuhën, traditat dhe zakonet, deri edhe mendësinë e tyre, dhe me dëshirë të zjarrtë u tregojmë dashurinë që Zoti e ka për ta, më shumë me qëndrimin tonë, si tharmi në brumë.

Jeta jonë kontemplative në mes të njerëzve bën që të kemi kontakte me njerëz të kulturave, besimeve fetare dhe shtresave shoqërore të ndryshme.

Eukaristia,

Adhurimi dhe

meditimi i Ungjillit

janë në qendrën

e jetës sonë

dhe mbajmë në


zemër

dëshirën e flaktë

që të dëshmojmë

dashurinë e Zotit

për të gjithë njerëzit.



Kapela e Motrave të Vogla në Tiranë



Katedralja e Shën Palit




Kisha Orthodhokse

Edhe këtu në Shqipëri,
BASHKIMI
 është fjala që shpreh misionin tonë.



Hyji është Ati i të gjithëve!



Xhamia e Et'hem Beut

Jam e sigurt që mund të ekzistojë një miqësi e vërtetë,
 një dashuri e thellë mes njerëzve që nuk kanë të njëjtën fe,
 të njëjtën racë dhe që nuk janë të të njëjtit vend.

Motra e Vogël Madëlenë e Jezusit